

Gripi sezonal në Kosovë
ka shënuar rritje dhe
kalon pragun epidemik



FAÇE 5

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

NJË VORBULL DYSHIMESH RRETH PETICIONIT PËR SHKARKIMIN E KRYETARËVE NË VERI TË KOSOVËS

FAÇE 4-5



Interpretimi i ndryshëm i
udhëzimit administrativ të
Qeverisë së Kosovës për

zëvendësimin e kryetarëve ka
shkaktuar edhe njëherë
konfuzion se deri ku ka arritur

procesi i zëvendësimit të
kryetarëve në katër komunat me
shumicë serbe në veri të Kosovës

AKTUALE



**IZRAELI MBROHET NË GJND KUNDËR
AKUZAVE PËR GJENOCID NDAJ
PALESTINEZËVE** F. 2

**POLICIA E KOSOVËS PAJISËT ME
ARMË TË GJATA** F. 2

**MJEKË DHE PROFESORË UNIVERSITARË
OBLIGOHEN TA DEKLAROJNË
PASURINË NGA 11 SHKURTI** F. 7

EKONOMI



**SHKËMBIMET TREGTARE
KOSOVË-SHOIPËRI THYEN REKORDIN
RRETH 440 MILIONË EURO** F. 8

**DASH-i:
VLERA E RAKETAVE
KUNDËRTANKE
QË KOSOVA
DËSHIRON T'I
BLEJË ËSHTË 75
MILIONË DOLLARË** F. 6



**KMDLNJ-ja: VENDOSJA E KAMERAVE
NË PRISHTINË, NË KUNDËRSHTIM TË
PLOTË ME TË DREJTAT E NJERIUT** F. 3



**RAFUNA THOTË SE SEKTORI
PRIVAT DHE AI PUBLIK DUHET
T'I RRYTIN PAGAT** F. 8

SPORT



**LAURA FAZLIU: ËNDËRROJ
REZULTATET E MAJLINDA KELMENDIT** F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjiibiznesi.com
info@kolegjiibiznesi.com
030-500 878 | 045-500 878
044-500 878 | 049-500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Izraeli mbrohet në GjND kundër akuzave për gjenocid ndaj palestinezëve

JERUSALEM, 12 JANAR - I akuzuar për kryerjen e gjenocidit kundër palestinezëve, Izraeli mbrojti luftën e vet në Gazë në paraqitjen para gjykatës më të lartë të Kombeve të Bashkuara të premten, një ditë pasi kryeministri Benjamin Netanyahu i hodhi poshtë akuzat për gjenocid. Izraeli, i cili u themelua pas Holokaustit, ka mohuar fuqimisht akuzat e ngritura nga Afrika e Jugut në një nga rastet më të mëdha që janë paraqitur ndonjëherë përpara një gjykate ndërkombëtare. Rasti ka tërhequr vëmendjen ndërkombëtare dhe ka shkaktuar protesta para gjykatës, nga të dyja palët.

Avokatët e Afrikës së Jugut i kërkuar gjykatës të enjten ta urdhërojë ndalimin e menjëhershëm të operacioneve ushtarake izraelite në territorin rrethuar, ku jetojnë 2.3 milionë palestinezë. Një vendim për këtë kërkesë ndoshta do të marrë javë, megjithëse çështja e plotë ka të ngjarë të zgjasë disa vjet. Këshilltari ligjor izraelit, Tal Becker, tha të premten në gjykatë se vendi po lufton në një “luftë që nuk e filloi dhe nuk e deshi”. “Në këto rrethana, vështirë se mund të ketë një akuzë më të rreme dhe më keqdashëse sesa akuzat kundër Izraelit për gjenocid”, shtoi ai.

Të premten Izraeli u përqendrua në brutalitetin e sulmeve të 7 tetorit, duke paraqitur video dhe audio që tregonin atë që ndodhi atë ditë. “Ata torturuan fëmijët para prindërve, dhe prindërit para fëmijëve, dogjën njerëz, duke përfshirë foshnja të gjalla, përdhunuan dhe gjymtuan

sistematikisht shumë gra, burra dhe fëmijë,” tha Becker.

Kërkesa e Afrikës së Jugut, tha ai, përbën një përpjekje për ta parandaluar Izraelin që të mbrohet kundër atij sulmi. Ai tha se akuzat për gjenocid duhet të kenë në shënjestër Hamasin - grupin palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian. “Ne jetojmë në një kohë kur fjalët janë të lira, në një epokë të medieve sociale dhe politikave të identitetit. Përpjekja për të kërkuar termin më të egër dhe për të fyer është bërë, për shumë, e papërmbyshme”, tha Becker në sallën e mbushur të gjykatës botërore në Hagë.

Ai shtoi se Afrika e Jugut “ka paraqitur para gjykatës një pamje thellësisht të shtrembëruar. Tërësia e çështjes së saj varet nga një përshkrim i dekontekstualizuar dhe manipulues i realitetit të armiqësive aktuale”.

Në deklaratën e tij hyrëse të premten në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, Becker kërkoi pushimin e çështjes, duke e quajtur atë “një shpifje”. Ai i tha gjykatës se Hamasi filloi dhunën me sulmin e tij të befasishëm të 7 tetorit në Izrael, në të cilin u vranë më shumë se 1 200 njerëz, ndërsa në gjykatë shfaqti pamjet e njerëzve të vrarë.

Ai i tregoi gjykatës, gjithashtu, videon e zyrtarit të Hamasit, Ghazi Hamad, i cili zotohej t'i vazhdonte sulmet me qëllim të asgjësimit të Izraelit. “Nëse ekziston një kërcënim për civilët palestinezë të Gazës, ai rrjedh kryesisht nga fakti se ata kanë jetuar nën kontrollin e një



organizatë terroriste gjenocidale që ka shpërfillje totale për jetën dhe mirëqenien e tyre”, tha Becker.

Në ditën e dytë të seancës dëgjimore në Hagë, Izraeli argumentoi se ofensiva e tij në Gazë është vetëmbrojtje legjitime dhe jo gjenocid.

Avokati Malcolm Shaw mbrojti Izraelin nga akuzat për gjenocid duke thënë se ofensiva e ashpër e Izraelit në Gaza ishte një përdorim legjitim i forcës së armatosur për vetëmbrojtje.

Shaw, i dyti nga gjashtë anëtarët e ekipit ligjor izraelit që foli, tha se numri i lartë i vdekjeve nuk përbën gjenocid. Ai tha se “gjenocidi i vërtetë” ndodhi kur militantët e Hamasit sulmuan Izraelin jugor më 7 tetor, duke vrarë rreth 1 200 njerëz.

Izraeli shpesh bojkoton gjykatat ndërkombëtare dhe hetimet e OKB-së, duke thënë se ato janë të padrejta dhe të njëanshme. Por, për të treguar se sa seriozisht e konsiderojnë rastin, udhëheqësit izraelitë kanë ndërmarrë hapin e rrallë të dërgimit të një ekipi ligjor të nivelit të lartë.

Në qendër të këtij rasti janë veprimet e Izraelit në Gaza, ku filloi një sulm masiv ajror dhe tokësor pasi militantët e Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - sulmuan Izraelin më 7 tetor, duke vrarë rreth 1 200 njerëz, kryesisht civilë. Ata,

gjithashtu, rrëmbyen rreth 250 persona, më shumë se gjysma prej të cilëve ende mbahen peng. Më shumë se 23 000 njerëz në Gaza janë vrarë gjatë luftës, sipas Ministrisë së Shëndetësisë në territorin e kontrolluar nga Hamasi. Gati 85 për qind e banorëve të Gazës janë dëbuar nga shtëpitë e tyre, një e katërta e banorëve të territorit përballen me urinë dhe pjesa më e madhe e Gazës veriore është kthyer në gërmadha.

Afrika e Jugut thotë se kjo përbën gjenocid dhe është pjesë e shtypjes izraelite, me dekada, ndaj palestinezëve. “Shkalla e shkatërrimit në Gazë, shënjestrimi i shtëpive familjare dhe civilëve, lufta si luftë kundër fëmijëve - të gjitha e bëjnë të qartë se qëllimi gjenocidal është kuptuar dhe është vënë në praktikë. Synimi i artikullar është shkatërrimi i jetës palestineze”, tha avokatja Tembeka Ngcukaitobi në deklaratat e hapjes të enjten.

Netanyahu i hodhi poshtë këto argumente. “Kjo është një botë e përmbysur - shteti i Izraelit akuzohet për gjenocid ndërsa po lufton gjenocidin”, tha kryeministri të enjten në një deklaratë me video. “Hipokrizia e Afrikës së Jugut arrin deri në qiell”, shtoi ai.

Marrëveshjet ndërkombëtare ende i detyrojnë vendet me rregullat e luftës, edhe në rastet kur i përgjigjen një sulmi, sado

serioz të jetë. Gjykata duhet të vendosë nëse operacionet e Izraelit kanë mbetur vërtet brenda këtyre kufizimeve.

Edhe pse gjetjet e gjykatës konsiderohen të detyrueshme, ishte e paqartë nëse Izraeli do të merrte parasysh ndonjë urdhër për t'i ndaluar luftimet. Nëse nuk e bën këtë, mund të përballen me sanksione të OKB-së, megjithëse ato mund të bllokohen nga një veto e Shteteve të Bashkuara - aleati i vendosur i Izraelit. Shtëpia e Bardhë nuk pranoi të komentojë se si mund të përgjigjet nëse gjykata vendos se Izraeli ka kryer gjenocid. Por zëdhënësi i Këshillit të Sigurisë Kombëtare, John Kirby, i quajti akuzat “të pabaza”.

Gjykata ndërkombëtare, e cila vendos për mosmarrëveshjet midis kombeve, nuk e ka gjykuar kurrë një vend si përgjegjës për gjenocid.

Në vitin 2007 vendosi se Serbia “shkeli detyrimin për ta parandaluar gjenocidin” në masakrën e korrikut 1995 nga forcat serbe të Bosnjës ndaj më shumë se 8 000 burrave dhe djemve të Srebrenicës.

Gjykata e OKB-së me seli në periferi të Hagës, në Holandë, merret me mosmarrëveshjet midis kombeve. Pak më larg në qytetin e njëjtë holandez ndodhet Gjykata Ndërkombëtare Penale e cila ndjek penalisht individë për krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe gjenocid.

Policia e Kosovës pajiset me armë të gjata

PRISHTINË, 12 JANAR - Nga dita e premtë të gjitha patrullat e Policisë së Kosovës do të pajisen me armë të gjata. Lajmin e ka dhënë ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla. “Me blerjen e këtyre armëve

për të gjitha patrullat policore anekënd Republikës së Kosovës rritet efikasiteti në luftimin e krimit me çka mundësohet një ambient më i sigurt, rend publik më i qetë dhe më shumë siguri për

zyrtarët tanë policorë. Falënderoj edhe shtetin mik kroat për bashkëpunimin e ngushtë dhe korrekt me institucionet e Republikës së Kosovës”, ka shkruar Sveçla në “Facebook”.



KMDLNj: Vendosja e kamerave në Prishtinë, në kundërshtim të plotë me të drejtat e njeriut

Përfaqësues të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, të Policisë së Kosovës dhe të komunës së Prishtinës, kanë diskutuar lidhur me procedurat për vendosjen e kamerave në Prishtinë. Udhëheqësit e këtyre institucioneve janë zotuar se do të sigurojnë që zbatimi i këtij projekti do të realizohet në harmoni të plotë me legjislacionin përkatës në fuqi. Vendosja e kamerave në Prishtinë ka ardhur pas kërkesës së Policisë së Kosovës me qëllim që ta ruajë sigurinë publike në kryeqytet. Por, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka theksuar se vendosja e kamerave në Prishtinë është në kundërshtim të plotë me të drejtat e njeriut

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 12 JANAR - Me qëllim të koordinimit ndërinstitutional, përkatësisht sigurimin e mbrojtjes së të dhënave personale të qytetarëve të Kosovës, udhëheqësit e institucioneve, Krenare Sogojeva-Dermaku, komisionare e Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP), Basri Shabani, drejtor i Drejtorisë Rajonale në Prishtinë nga Policia e Kosovës (PK) dhe Lulzim Fushtica, drejtor për Siguri dhe Emergjencë i kryeqytetit, janë takuar për të diskutuar lidhur me vendosjen e kamerave në Prishtinë. Kërkesa për blerjen dhe vendosjen e kamerave brenda hapësirave publike në kryeqytet, që ka për qëllim ruajtjen e rendit dhe sigurinë publike, parandalimin dhe zbulimin e veprave penale, identifikimin, gjetjen dhe kapjen e kryerësve të veprave penale, si dhe arrijten e objektivave të tjera të

ligjshme policore, është bërë nga Policia e Kosovës, drejtuar nga komuna e Prishtinës. Projekti me specifikat teknike është përgatitur nga grupi punues në përbërje të anëtarëve nga Policia e Kosovës dhe të kryeqytetit. Monitorimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë do ta bëjë Policia e Kosovës dhe, po ashtu, infrastruktura teknike e pajisjeve, ruajtja dhe mbikëqyrja, do të sigurohen nga Policia e Kosovës. Sistemi i regjistrimit të të dhënave, që do të bëhet nga këto kamera, do të krijojë mundësinë e vlerësimeve statistikore, pa përfshirë përpunimin e karakteristikave biometrike dhe menaxhimi i tyre do të bëhet vetëm nga Policia e Kosovës mbi bazën e autorizimeve ligjore të saj. Udhëheqësit e këtyre institucioneve janë zotuar se do të sigurojnë që zbatimi i këtij projekti do të realizohet në harmoni të plotë me legjislacionin përkatës në



fuqi. Agjencia për Informim dhe Privatësi i ka siguruar qytetarët se, bazuar në mandatin ligjor, do ta bëjë monitorimin e zbatimit të këtij projekti për ta siguruar zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke përfshirë edhe inspektimin e realizimit të projektit. Por këtë e ka kundërshtuar Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNj), duke theksuar se vendosja e kamerave në Prishtinë është në kundërshtim të plotë me të drejtat e njeriut. “Vendosja e kamerave të sigurisë e sidomos këto me inteligjencë

artificiale është e ndaluar në shumë vende shkaku i mundësisë së keqpërdorimit të të dhënave biometrike që i përpunojnë këto kamera. Pastaj, sipas legjislacionit në fuqi, vëzhgimi me anë të kamerave edhe për rastet më të rënda kriminale nuk mund të bëhet pa lejen e organeve ligjzbatuese dhe se ajo trajtohet si rast e jo si tërësi. Në rastin e vendosjes së kamerave në kryeqytet po mendohet që vëzhgimi të jetë i përhershëm, 24 orë dhe këtu do të përfshihen të gjithë qytetarët që janë brenda perimetrit që mbulohen nga kamerat pavarësisht nëse janë të

dyshuar apo jo”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së, duke shtuar se KMDLNj kundërshton fuqishëm vendosjen e kamerave me inteligjencë të fuqishme artificiale për faktin se nuk është paraparë me legjislacionin në fuqi. “Në mënyrë brutale krijon kushte për shkelje të privatësisë dhe të drejtat e njeriut. Kamerat për vëzhgim mund të vendosen vetëm në hapësira ku ekziston dyshimi i bazuar për vepra penale dhe me leje të organeve ligjzbatuese apo në hapësira ku prishmëritë për shkelje të privatësisë janë të vogla”, është bërë me dije në reagimin e KMDLNj-së.

O’Brien: Nuk do të lejojmë dhunë në veri të Kosovës

PRISHTINË, 12 JANAR - Ndihmëssekretari amerikan i Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, James O’Brien, tha se ngjarje të dhunshme në veri të Kosovës, pas ngjarjeve në Banjskë në shtatorin e vitit të kaluar, Uashingtoni nuk do të lejojë të përsëriten. Gjatë një bashkëbisedimi virtual me gazetarë, O’Brien u bëri thirrje Kosovës dhe Serbisë t’i shmangin veprimet provokuese në veriu të Kosovës të banuar me shumicë serbe. Ai tha se është i kënaqur me bashkëpunimin e Policisë së Kosovës me misionin paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR, në pjesën veriore të Kosovës, teksa rikujtoi se prania e paqeruajtësve ndërkombëtarë në këtë pjesë është rritur muajtë fundit. “Po ashtu, komunikimi dhe bashkëpunimi me Beogradin na ka lejuar një lloj qetësimi të situatës. Ne presim që kjo të vazhdojë dhe në muajt në vijim presim më shumë transparencë dhe diskutime. Kjo është shumë e rëndësishme veçmas pas



ngjarjeve shtatorin e kaluar, kur një grup tentoi të dërgonte një sasi armësh që do të shkaktonin dhunë të madhe, nëse ata do të mund të çonin në fund planet e tyre. Mendoj se kjo është diçka që të dyja palët e kuptojnë se nuk do të lejohet të ndodhë dhe askush nuk dëshiron që kjo të përsëritet”, tha ai. O’Brien iu referua sulmit në

Banjskë të Zveçanit ndaj Policisë së Kosovës nga një grup i armatosur serbësh. Ky grup vrau një polic, ndërkaq gjatë përleshjeve u vranë edhe tre sulmues. Kosova e fajësoi Serbinë për sulmin, por Beogradi mohoi çdo përfshirje. Përgjegjësinë për sulmin, që Kosova e konsideron terrorist, e mori Millan Radoičiq, ish-

nënkryetar i Listës Serbe - partisë kryesore të serbëve në Kosovë, që gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar. Zyrtari i lartë amerikan tha se Ballkani Perëndimor “duhet të jetë evropian, stabil dhe i sigurt, mbi të gjitha ky rajon ka nevojë për integrim ekonomik”. Ai tha se kjo çështje është kyçe për gjashtë shtetet e Ballkanit

Perëndimor, pasi popullsia e tyre po largohet për shkak të mungesës së perspektivës ekonomike. O’Brien përsëriti se qëndrimi i ShBA-së nuk ka ndryshuar sa i përket mbështetjes së procesit të dialogut për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. Ai u bëri thirrje palëve t’i zbatojnë përgjegjësitë e tyre që dalin nga ky proces. Ai tha se ka pasur përparim në zbatimin e zotimeve të dialogut, sikurse ishte çështja e targave të makinave. Zyrtari i lartë amerikan foli edhe për parregullsitë e raportuara nga vëzhguesit ndërkombëtarë për zgjedhjet parlamentare, lokale dhe krahinore që Serbia mbajti më 17 dhjetor 2023. Ai tha se Uashingtoni pret që të punojë me qeverinë serbe që të adresohen këto shqetësime, ndërkaq tha se ShBA-ja mbështet protestat paqësore në Serbi “nga njerëzit që ndiejnë se zgjedhjet ishin jo fer dhe që rezultatet nuk ishin ashtu siç ata prisnin”.



Një vorbull dyshimesh rreth peticionit për shkarkimin e kryetarëve në veri të Kosovës

Interpretimi i ndryshëm i udhëzimit administrativ të Qeverisë së Kosovës për zëvendësimin e kryetarëve ka shkaktuar edhe njëherë konfuzion se deri ku ka arritur procesi i zëvendësimit të kryetarëve në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës

PRISHTINË, 12 JANAR - Interpretimi i ndryshëm i udhëzimit administrativ të Qeverisë së Kosovës për zëvendësimin e kryetarëve ka shkaktuar edhe njëherë konfuzion se deri ku ka arritur procesi i zëvendësimit të kryetarëve në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës. Nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) thonë se është duke u bërë mbledhja e nënshkrimeve për peticionin për shkarkimin e kryetarit dhe se emri për një gjë të tillë ka mbetur rreth dy javë. Grupi i qytetarëve - të cilët sipas udhëzimit administrativ duhet t'i mbledhin këto nënshkrime - thotë se nuk e ka marrë dokumentacionin e nevojshëm për ta nisur peticionin dhe se askush nuk i ka njoftuar se ka një afat kohor për këtë. Kryetarët e kuvendeve komunale të cilët supozohet se do të jenë një lloj ndërmjetësi mes qytetarëve dhe pushtetit qendror pohojnë se

e kanë bërë punën e tyre dhe se tani u takon qytetarëve ta nisin peticionin. Serbët nga veriu i Kosovës u larguan nga institucionet e Kosovës në nëntor të vitit 2022, përfshirë edhe ata në pushtetin lokal. Pasi bojkotuan zgjedhjet e jashtëzakonshme në prill, kur në krye të komunave erdhën shqiptarët, partia më e madhe e serbëve në Kosovë, Lista Serbe, njoftoi në mes të tetorit të vitit 2023 se është gati të marrë pjesë në zgjedhjet e jashtëzakonshme në komunat në veri të Kosovës.

Çfarë kontestohet?

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Kosovës (KQZ) njoftoi në mes të dhjetorit të vitit të kaluar se kryetarët e kuvendeve komunale, grupet dhe iniciativat qytetare dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të Kosovës janë njoftuar për numrin e përditësuar

të votuesve të regjistruar në këto tri komuna.

Ai hap është i paraparë me udhëzim administrativ, sepse për peticion duhet mbledhur 20 për qind e nënshkrimeve nga numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar me të drejtë vote.

Kjo duhet të jetë një shenjë se mbledhja e nënshkrimeve mund të fillojë, por mbetet e paqartë nëse, para këtij hapi, Grupi Iniciues ishte regjistruar zyrtarisht për ta filluar peticionin dhe nëse mori leje për të përdorur një zonë ose hapësirë publike për këtë qëllim, sepse palët paraqesin pretendime krejtësisht të ndryshme.

Procesi i zëvendësimit të kryetarëve të komunave në Mitrovicën e Veriut, Leposaviq, Zvečan dhe Zubin Potok, pasoi tensionet e larta në fund të majit të vitit të kaluar kur kryetarët shqiptarë erdhën në pushtet për shkak se serbët i bojkotuan zgjedhjet.

Nën presionin e bashkësisë ndërkombëtare, në fillim të shtatorit 2023 Prishtina zyrtare hartoi një udhëzim administrativ që mundëson largimin e atyre kryetarëve të komunave dhe shpalljen e zgjedhjeve të reja.

Mirëpo tash e një muaj po vazhdon "diskutimi" mes aktorëve për zëvendësimin e kryetarëve.

Çfarë thuhet në udhëzimin administrativ?

Udhëzimi administrativ i Qeverisë së Kosovës për shkarkimin e kryetarit, para mbledhjes së nënshkrimeve në kuadër të peticionit për shkarkimin e kryetarit, parasheh një sërë hapash, i pari prej të cilëve është formimi i Grupit Iniciues, i cili përbëhet nga së paku tre persona që përfaqësojnë kërkesën e një komune të caktuar. Ai grup, para se ta fillojë mbledhjen e nënshkrimeve, duhet ta informojë kryetarin e Kuvendit të Komunës si dhe mund ta njoftojë edhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

Më pas, kryetari i Kuvendit Komunal për këtë iniciativë qytetare e njofton kryetarin e komunës, Ministrinë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe KQZ-në.

Pas kësaj, kryetari i Kuvendit të Komunës ka afat prej pesë ditësh

të regjistrojë Grupin Iniciues si person i autorizuar për të mbledhur nënshkrime dhe për të kërkuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve një numër të përditësuar të votuesve të regjistruar, sepse për shkarkimin e kryetarit është e nevojshme të mbledhen të paktën 20 për qind e nënshkrimeve nga numri i përgjithshëm i personave me të drejtë vote. Kryetari i Kuvendit të Komunës është i obliguar që pastaj t'ia dorëzojë Grupit Iniciues dokumentacionin e nevojshëm për mbledhjen e nënshkrimeve si dhe autorizimin për shfrytëzimin e hapësirës publike për mbledhjen e nënshkrimeve.

Më pas ky grup ka 30 ditë kohë për të mbledhur nënshkrime për zëvendësimin e shefit të policisë dhe afati mund të shtyhet vetëm një herë për 15 ditë.

Nëse KQZ-ja konfirmon se nënshkrimet e mbledhura janë të përshtatshme dhe i verifikon, organizohet votimi për shkarkimin e kryetarit, i cili duhet të mbahet brenda 45 ditëve. Që ky votim të jetë i suksesshëm, kërkohet 50 për qind plus një votë e qytetarëve me të drejtë vote. Pas kësaj, rezultati i dërgohet

Gripi sezonal në Kosovë ka shënuar rritje dhe kalon pragun epidemik



PRISHTINË, 12 JANAR - Ministria e Shëndetësisë ka reaguar në lidhje me situatën epidemiologjike me gripin sezonal.

MSH-ja ka theksuar se, sipas të dhënave të fundit nga IKShPK-ja dhe nga institucionet shëndetësore, intensiteti i gripit sezonal sipas numrit të rasteve të raportuara për javën e parë të vitit 2024 paraqitet me aktivitet më të lartë të qarkullimit dhe, krahasuar me javën paraprake, ka shënuar rritje dhe e kalon pragun epidemik. “Si rrjedhojë apelojmë për vigjilencë të shtuar. Në rast simptomash të gripit konsultoni mjekun familjar për këshilla dhe trajtim të duhur. Masat e rëndësishme për parandalim: 1. Mbulojini hundën dhe gojën kur teshtini dhe kolliteni; 2. Praktikoni higjienën e duarve dhe

shmangni kontaktet e afërta me të sëmurët; 3. Nëse jeni i sëmurë, qëndroni në shtëpi për ta parandaluar përhapjen e mëtejshme; 4. Ushqimi i shëndetshëm me më shumë lëngje, kryesisht vitamina dhe gjumi i mjaftueshëm janë të rëndësishëm”, ka njoftuar MSH-ja.

Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, është veçanërisht e rëndësishme që grupet si: personeli shëndetësor, gratë shtatzëna, fëmijët, të moshuarit dhe personat me imunitet të dobësuar, të kenë kujdes më të shtuar gjatë sezonit të gripit. “Vaksinimi është mbrojtja më e mirë kundër gripit. Qysh në fillim të tetorit 2023 Ministria e Shëndetësisë ka siguruar 85 000 doza të vaksinës sezonale”, është bërë me dije në njoftimin e MSH-së.

Nga e hëna nisin seancat gjyqësore në rastin e liderëve të UÇK-së

PRISHTINË, 12 JANAR - Në Gjykatën Speciale në Hagë më 15 janar (e hënë) do të fillojnë seancat gjyqësore për vitin 2024 në gjykimin ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Në këtë çështje gjyqësore deri më tani janë dëgjuar gjithsej 38 dëshmitarë të Zyrës së

Prokurorit të Specializuar (ZPS).

Në njoftimin javor të Gjykatës Speciale, të enjten është bërë me dije se trupi gjykues ka pranuar pjesërisht kërkesën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) që të pranohen si prova deklaratat me shkrim të disa

dëshmitarëve që kanë dhënë dëshmi në çështje të tjera. Sipas zëdhënësit Michael Doyle, kjo kërkesë përfshinte edhe deklaratat e disa dëshmitarëve që tashmë kanë vdekur. Po ashtu, edhe katër seanca që janë paraparë për muajin shkurt në këtë çështje gjyqësore janë anuluar.



presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, e cila ka një afat ligjor prej 30 deri në 45 ditësh për t'i shpallur zgjedhjet e parakohshme.

Çfarë thotë Ministria?

Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, tha më 10 janar se qytetarët e Mitrovicës së Veriut, Leposaviqit dhe Zubin Potokut kanë edhe 12 ditë kohë për t'i mbledhur nënshkrimet e nevojshme për shkarkimin e kryetarëve shqiptarë.

Ai afat për qytetarët e komunës së Zveçanit është më i gjatë për rreth pesë ditë, sepse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është dorëzuar më vonë kërkesa për listën me numrin e saktë të votuesve të regjistruar. Ky hap parashihet edhe me udhëzimin e paralajmërues se në petition janë mbledhur 20 për qind e nënshkrimeve nga numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar.

Ministri Krasniqi, po ashtu, tha se më 9 janar se ka mbajtur një takim me shtetet e Quint-it dhe diplomatët e BE-së lidhur me procesin e ndërrimit të kryetarëve shqiptarë në veri. Ai theksoi se peticioni ka nisur në dhjetor të vitit të kaluar dhe se mbledhja e nënshkrimeve është duke vazhduar.

Mirëpo, grupe qytetarësh e demantojnë këtë dhe thonë se nuk kanë filluar mbledhjen e nënshkrimeve, sepse nuk morën konfirmim nga kryetari i Kuvendit të Komunës se janë regjistruar si një grup iniciues, i cili, sipas udhëzimit administrativ, është i vetmi që mund të fillojë një petition.

Lidhur me këtë, Radio Evropa e Lirë kontaktoi me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, por nuk mori përgjigje.

“Nuk dimë çfarë të bëjmë më pas”

Vesellin Radoviq, i cili është pjesë e Grupit Iniciues të Qytetarëve në Leposaviq, thotë për Radion Evropa e Lirë se është në pritje të takimit me kryetarin e Kuvendit të Komunës për të “arritur marrëveshje për interpretimin e udhëzimit administrativ”.

“Nuk e kemi marrë dokumentacionin e nevojshëm dhe kërkojmë shpjegim se pse nuk po bëhet kjo. Thjesht, nuk jemi në gjendje ta zbatojmë petitionin derisa ta marrim dokumentacionin e plotë”, thotë Radoviq.

Në anën tjetër, kryetari i Kuvendit të Komunës së Leposaviqit, Gorski Buriq, pohoi se ka bërë punën e tij, se Grupit Iniciues ia ka dhënë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe se i takon t'i

mbledhë nënshkrimet. “Atyre u takon të gjejnë një dhomë dhe ta fillojnë procesin e mbledhjes së nënshkrimeve”, u shpreh Buriq për Radion Evropa e Lirë.

Mirëpo, Radoviq tha se përcaktimi i vendit për fillimin e petitionit është “fazë tjetër” sipas udhëzimit administrativ dhe se, para së gjithash, është e nevojshme që zyrtarisht të regjistrohet si Grup Iniciues. “Thjesht, nuk dimë çfarë të bëjmë më pas, faza tjetër është autorizimi për dhomën (për ta filluar petitionin). Jemi në pritje të një ftese (nga kryetari i Kuvendit të Komunës) për të parë se si do të vazhdojmë, çfarë hapi të hedhim”, theksoi ai.

Radoviq shpreh besimin se për një proces të suksesshëm të zëvendësimit të kryetarit, së pari duhet vullneti i mirë i të gjithë aktorëve, por edhe fleksibilitet në harmonizimin e pozicioneve dhe interpretimin e udhëzimeve administrative.

Një anëtar i grupit iniciues në Mitrovicën Veriore dhe Zveçan konfirmoi për Radion Evropa e Lirë se nuk ka filluar mbledhjen e nënshkrimeve, por nuk ka dashur të flasë më shumë për këtë dhe as të publikohen emrat e tyre.

Dyshimet për hapat për zëvendësimin e kryetarit në veri kanë qenë të pranishme që në fillim të procesit, kur një grup qytetarësh tentuan ta nisin atë iniciativë më 5 dhjetor.

Uglanin: Askush nuk kërkoi leje për hapësirë publike për të mbledhur nënshkrime

Kryetari i Kuvendit të Komunës së Mitrovicës Veriore, Nexhad Uglanin, tha për Radion Evropa e Lirë se një grupi të qytetarëve ua ka dorëzuar formularin për të filluar një petition mbi bazën e të cilit duhet të mbledhen nënshkrimet dhe se është në dorën e tyre të informojnë se ku do ta bëjnë mbledhjen e nënshkrimeve. Siç tha ai, ende nuk ka marrë ndonjë kërkesë prej tyre për ta përcaktuar hapësirën publike ku do të niste peticioni për mbledhjen e nënshkrimeve. “Ua kam dërguar njoftim se janë të obliguar ta informojnë Kuvendin e Komunës së Mitrovicës së Veriut, i cili menjëherë cakton seancë dhe jep autorizimin (për shfrytëzimin e hapësirës publike). Nëse do ta përdorin një zonë publike, një shëtitore, nëse do ta përdorin një shkollë apo ndonjë institucion tjetër, varet nga ata. Ky është problemi më i vogël për ne”, sqaroi Uglanin.

Në vërejtjen e Grupit Iniciues se nuk është regjistruar zyrtarisht, Uglanin tha se është dashur ta bëjë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe se, ndoshta, është bërë sepse janë informuar për

numrin e nënshkrimeve që duhet të mbledhin.

Sa vota duhen të mbledhin?

Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, nuk u përgjigj konkretisht nëse ky institucion e kishte regjistruar Grupin Iniciues për mbledhjen e nënshkrimeve, por tha se partitë ishin të informuara për numrin e përditësuar të votuesve dhe se ishte specifikuar saktësisht se sa nënshkrime duheshin mbledhur për zëvendësimin e kryetarit të komunës. Në komunën e Leposaviqit të drejtë vote kanë 13 441 persona, që do të thotë se së paku 2.689 prej tyre duhet ta nënshkruajnë petitionin për shkarkimin e kryetarit të komunës.

Në Zubin Potok peticionit duhet t'i përgjigjen së paku 1 347 votues, që është 20 për qind e 6 732 votuesve të regjistruar.

Më së shumti nënshkrime në petition duhet të mbledhen në Mitrovicën e Veriut, së paku 3 640, sepse në listën zgjedhore janë regjistruar 18 199 persona me të drejtë vote.

Kurse në Zveçan peticioni duhet të nënshkruhet nga së paku 1 411 persona, që është 20 për qind e numrit të përgjithshëm të votuesve të regjistruar, sipas nevojës për organizimin e votimit për shkarkimin e kryetarit sipas udhëzimit administrativ.

DASH-i: Vlera e raketave kundërtanke që Kosova dëshiron t'i blejë është 75 milionë dollarë

PRISHTINË, 12 JANAR - Departamenti amerikan i Shtetit konfirmoi për "Radion Evropa e Lirë" se Kosova ka bërë kërkesë që të blejë raketa Javelin në vlerë prej 75 milionë dollarësh. Bëhet fjalë për 246 raketa kundërtanke të këtij lloji, që prodhohen nga ShBA-ja, sipas një njoftimi të Agjencisë Amerikane për Bashkëpunim në Siguri.

Në një përgjigje dërguar "REL"-it, DASH-i tha se më 11 janar administrata amerikane e ka njoftuar Kongresin për propozimin e programit për Shitjet e Huaja Ushtarake (FMS) për rastin e shitjes së raketave Javelin dhe pajisjeve të tjera të lidhura me to për Kosovën. "Departamenti Amerikan i Shtetit shpesh ka vendosur ta miratojë shitjen e huaja ushtarake për Ministrinë e Mbrojtjes së Kosovës për përdorimin e armëve nga Forcat e Sigurisë së Kosovës", tha DASH-i.

Shitja e këtyre armëve, sipas DASH-it, mbështet "politikën e jashtme dhe objektivat e sigurisë kombëtare të ShBA-së duke përmirësuar sigurinë e Kosovës dhe zhvillimin e aftësive të saj mbrojtëse, të ndërveprueshme me NATO-n, pa ndryshuar ekuilibrin thelbësor ushtarak në rajon ose pa ndikuar në gatishmërinë mbrojtëse të ShBA-së", tha një zëdhënës i DASH-it për "Radion Evropa e Lirë".

ShBA-ja, sipas DASH-it, vazhdon ta mbështesë Kosovën në transformimin "transparent të Forcës së Sigurisë së Kosovës në një forcë shumëtnike për mbrojtje territoriale, të ndërveprueshme me NATO-n, që i nënshtrohet mbikëqyrjes civile".

Sipas Agjencisë Amerikane për Bashkëpunim në Siguri, në pakon



mbrojtëse që Kosova ka bërë kërkesë të blejë, përveç 246 raketave Javelin FGM-148F - përfshirë gjashtë raketa testuese që i dërgohen blerësit kur ta pranojë dërgesën - janë edhe 24 njësi për lëshimin e raketave Javelin, si dhe udhëzues të tjerë për përdorimin e raketave dhe pajisjeve përcjellëse.

Sipas kësaj agjencie, kontraktorët e kësaj marrëveshjeje do të jenë kompanitë që prodhojnë raketat Javelin, Lockheed Martin dhe Raytheon Missiles and Defense. "Shitja e propozuar e këtyre armëve do t'i përmirësojë aftësitë mbrojtëse të Kosovës, në terma afatgjatë, për ta mbrojtur sovranitetin dhe integritetin territorial dhe që t'i përmbushë kërkesat e saj të mbrojtjes kombëtare. Kosova nuk do të ketë vështirësi t'i përfshijë këto pajisje në forcat e saj të armatosura", tha Agjencia për bashkëpunim në

siguri.

Më herët, gjatë 11 janarit, nga Ministria e Mbrojtjes e Kosovës i thanë Radios Evropa e Lirë se blerja e raketave Javelin është paraparë në kuadër të ngritjes së kapaciteteve ushtarake të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). "FSK-ja është duke i ngritur kapacitetet ushtarake dhe, në këtë aspekt, ekziston një marrëveshje ushtarake e nënshkruar në mes të Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që funksionon në kuadër të programit FMS, që blerjet të realizohen nëpërmjet këtij programi. Dhe, në këtë aspekt, janë të përfshirë edhe raketa Javelin dhe disa sisteme të tjera moderne të armatimit", ka thënë Liridona Gashi, këshilltare politike e ministrit të Mbrojtjes, Ejup Maqedonci.

Programi FMS (shitjet e huaja ushtarake) është një program i

ushtresë amerikane për të ofruar ndihmë të sigurisë dhe është një "mjet thelbësor i politikës së jashtme amerikane", thuhet në uebfaqen e Agjencisë Amerikane për Bashkëpunim në Siguri. Sipas këtij programi, qeveria amerikane dhe një qeveri e huaj mund të arrijnë marrëveshje ndërqeveritare, që quhet Letër e Ofertës dhe Pranimit.

Njoftimi për synimin e Kosovës që të blejë sisteme raketore nga ShBA-ja vjen në kohën kur tensionet në mes të Kosovës dhe Serbisë janë të larta. Presidenti serb Aleksandar Vuçiq e ka cilësuar këtë lajm "zhgënjim i madh".

Në muajt e fundit ushtria serbe disa herë ka lëvizur trupat drejt kufirit me Kosovën, kufi që ruhet nga misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë, KFOR, teksa u regjistruan disa incidente në veriun e Kosovës - të banuar me

shumicë serbe - përfshirë edhe një sulm të armatosur nga një grup serbësh ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë të Zveçanit.

ShBA-ja ka thënë se dhuna e parë në Banjskë, ku u vra një polic i Kosovës dhe gjatë përleshjeve që pasuan u vranë dhe tre sulmues serbë, nuk do të lejohet që të përsëritet.

Kosova edhe në të kaluarën ka blerë ose ka pranuar në formë donacioni armë nga Shtetet e Bashkuara.

Pasi u miratuan ndryshimet në Kuvendin e Kosovës më 2018, qeveria e atëhershme nënshkroi një kontratë me kompaninë amerikane AM General për pajisjen e FSK-së me 51 automjete të tipit Humvee. Dy vjet më vonë Kosova bleu edhe automjete të tjera ushtarake nga ShBA-ja, ndërkaq më 2021 qeveria amerikane i dhuroi Kosovës 55 automjete të tipit ASV (Armored Security Vehicle).

Qeveria e Kosovës ka miratuar edhe një vendim për blerjen e dronëve amerikanë, ndërkaq autoritetet e Kosovës kanë paralajmëruar se ushtria e ardhshme do të pajisjet edhe me helikopterë.

Më 2028, kur pritet që FSK-ja të shndërrohet ushtri, ajo parashihet t'i arrijë të gjitha kapacitetet operacionale për, siç është thënë, "ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës, si dhe të qytetarëve, pronave dhe interesave të vendit".

FSK-ja aktualisht ka rreth 2 500 pjesëtarë. Pas periudhës së tranzicionit, ky numër pritet të rritet në mbi 7 500 dhe të përfshijë pjesëtarë aktivë dhe rezervistë. Buxheti për këtë vit i Ministrisë së Mbrojtjes së Kosovës është në vlerë prej 153.049.911 eurosh.

Raketat kundërtanke nga ShBA-ja, Osmani beson se Kongresi do ta mbështesë kërkesën e Kosovës

PRISHTINË, 12 JANAR - Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, ka thënë se Republika e Kosovës po hyn në një fazë të re dhe vendimtare të fuqizimit të kapaciteteve shtetërore të mbrojtjes. "Kjo përfshin zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës konform standardeve të NATO-s dhe thellimin e marrëdhënieve me partneren tonë strategjik - Shtetet e Bashkuara të Amerikës", ka shkruar Osmani në "Facebook".

Ajo ka theksuar se si presidente e Republikës dhe Komandante Supreme e FSK-së shpreh mirënjohjen për institucionet tona të mbrojtjes të cilat për vite me radhë punuan për përmbushjen e kriterëve për kualifikim në Programin e Shitjeve Ushtarake të Departamentit të Shtetit të

ShBA-së. "Shpreh falënderim të veçantë për sekretarin Blinken me të cilin kemi diskutuar mbi miratimin e programit të Shitjeve Ushtarake të Huaja (FMS) në korrik 2022, për Departamentin e Mbrojtjes së ShBA-së dhe Kongresin e Shteteve të Bashkuara, i cili tashmë është njoftuar zyrtarisht për synimin e Kosovës për të blerë sisteme mbrojtëse armësh përmes programit FMS. Siç u tha në Deklaratën thelbësore të Qeverisë amerikane: 'Kjo shitje e propozuar do t'i mbështesë qëllimet e politikës së jashtme dhe sigurinë kombëtare të Shteteve të Bashkuara duke përmirësuar sigurinë e një partneri evropian që është një forcë e rëndësishme për stabilitetin politik dhe ekonomik në Evropë. Shitja e



propozuar gjithashtu do ta rrisë kapacitetin afatgjatë mbrojtës të Kosovës për ta mbrojtur sovranitetin dhe integritetin territorial, si dhe për t'i

përmbushur kërkesat shtetërore në sferën e mbrojtjes'. Kam besim të plotë se Kongresi do ta mbështesë këtë shitje të mundshme për vendin më

proamerikan në botë, si një akt i cili do ta rrisë sigurinë në Kosovë, në rajonin tonë, si dhe në kontinentin evropian", ka shkruar presidentja Osmani.

Një hap më afër jetësimit të projektit për Komplexin Memorial “Masakra e Reçakut”

PRISHTINË, 12 JANAR - Një mbledhjen e fundit të Qeverisë së Kosovës u miratua iniciimi i procedurës për shpronësimin e pronës së paluajtshme që i hap rrugë realizimit të këtij projekti. Kjo po bëhet në prag të 25-vjetorit të përkujtimit të një prej ngjarjeve më të dhimbshme të vendit tonë, masakrës së Reçakut, dëshmi për gjenocidin e kryer nga Serbia ndaj shqiptarëve. Ky projekt i rëndësisë së veçantë është duke u përgatitur në bashkëpunim të ngushtë në mes të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale dhe komunës së Shtimes.



Mjekë dhe profesorë universitarë obligohen ta deklarojnë pasurinë nga 11 shkurti

PRISHTINË, 12 JANAR - Nga data 1 deri më 31 mars 2024, zyrtarët publikë në Kosovë do të jenë të obliguar të bëjnë deklarinë e pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK). Rreth dhjetë mijë zyrtarë publikë, nisur nga presidentja, kryeministri, ministrat, deputetët, kryetarët e komunave e deri te mijëra zyrtarë të tjerë që kanë pozita udhëheqëse, janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë në Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK). “Procesi i deklarimit të rregullt vjetor, sipas ligjit, fillon më 1 mars dhe përfundon me 31 mars të secilit vitit kalendarik. Këtë vit deklarimit të rregullt vjetor pritet t’i nënshtrohen rreth dhjetë mijë (10 000) subjekte deklaruese”, thuhet në përgjigjen e tyre për “Front Online”. Këtë vit, ndryshe nga të tjerët, këtij procesi do t’i



nënshtrohen edhe mjekët e institucioneve shëndetësore sekondare dhe terciare, si dhe profesorët e universiteteve publike. Deklarimin e pasurisë ata do ta bëjnë nga 11 shkurti i këtij viti. Numri i saktë, sipas AKK-së, nuk dihet ende, por pritet të jetë rreth 1 000. “Afati tridhjetëditor i deklarimit të pasurisë për mjekët e institucioneve shëndetësore sekondare dhe terciare, si dhe për profesorët e universiteteve publike fillon më 11 shkurt 2024. Edhe pse në këtë fazë nuk mund ta dimë saktë, numri i

përgjithshëm i tyre pritet të jetë rreth një mijë (1 000) subjekte deklaruese”, kanë thënë nga AKK-ja. Nga Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) kanë treguar se pasuria e deklaruar e mjekëve dhe profesorëve universitarë do të jetë e qasshme për publikun. “Në përputhje me ligjin, regjistrat e pranuar nga këto subjekte deklaruese do të jenë të qasshme për publikun”, thuhet më tej në përgjigje. Nga kjo agjenci kanë thënë se pas deklarimit të pasurisë nga mjekët dhe profesorët, kompletohen të gjitha kategoritë deklaruese të obliguara ta deklarojnë pasurinë sipas legjislacionit të ri të Agjencisë. Agjencia Kundër Korrupsionit ka treguar se janë më shumë se pesë mijë (5 000) subjekte deklaruese që kanë deklaruar pasurinë për herë të parë në vitin 2023.

“CNN” shpall Piramidën e Tiranës ndër projektet më të mira arkitekturore të vitit

TIRANË, 12 JANAR - “Në qendër të qytetit të Tiranës, Shqipëri, banorët dhe vizitorët mund të ngjiten në një piramidë monumentale që dikur ishte simboli i një diktature shtypëse, këmbët e tyre që shkelin si triumf mbi të kaluarën”, nis shkrimin prestigjiozja “CNN” për Piramidën e Tiranës, të cilën e rendit mes projekteve më të mira të vitit. “CNN” shkruan se Piramida e Tiranës është një nga 18 projektet e reja të arkitekturës që Architectural Digest, e cilësuar si ndër më spektakolarja e vitit përmes listës vjetore “Works of Wonder” ose “WOW”. “E riimagjinuar nga studioja holandeze e arkitekturës MVRDV, Piramida e Tiranës është shndërruar nga një ish-muze i rrënuar kushtuar ish-liderit të

vendit (dhe më vonë i përdorur si bazë e NATO-s, ndër të tjera) në një qendër kulturore me kuti shumëngjyrëshe, shkallë dhe rrëshqitje të pjerrëta”, shkruan “CNN”. Në një kohë kur ndryshimi i klimës duket i madh në imagjinatën tonë kolektive dhe kur ndërtimet e reja vazhdojnë të lënë një gjurmë të madhe karboni - ndihej e rëndësishme të vihej në pah se si arkitektura ekzistuese mund të përshtatet për të ardhmen”, Sam Cochran, drejtor i karakteristikave globale të AD. Çdo vit, lista “WOW” nxjerr në pah projekte të reja të jashtëzakonshme në mbarë globin, me projektet e paraqitura të këtij viti që vijnë nga pesë kontinente të ndryshme. Lajmin e ka shpërndarë në “Facebook” edhe kryeministri Edi Rama.



Kurti dhe Vuçiqi javën tjetër në Zvicër

PRISHTINË, 12 JANAR - Ambasadori i Gjermanisë në Kosovës, Jorn Rohde, ka bërë me dije se kryeministri Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë Aleksandar Vuçiq do të jenë pjesë e Forumit Ekonomik Botëror në Davos

- Zvicër. “Forumi Ekonomik Botëror në Davos do të nisë javën tjetër. Nga të gjitha temat relevante, ‘arritja e sigurisë dhe bashkëpunimit në një botë të ndarë’, në veçanti reflekton për Kosovën, dialogun Kosovë -

Serbi dhe gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor. I kënaqur që shoh se Albin Kurti dhe Aleksandar Vuçiq do të jenë aty”, ka shkruar Rohde në X. Forumi në Davos do të mbahet nga 15-19 janar.



Rafuna thotë se sektori privat dhe ai publik duhet t'i rritin pagat

PRISHTINË, 12 JANAR - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, ka thënë se në dy vitet e fundit ka lëvizje të të rinjve dhe të rejave nga Kosova, si të fuqisë punëtore të kualifikuar dhe asaj të pakualifikuar. Në një intervistë për “Telegraf-in”, ai ka thënë se pas liberalizimit të vizave lehtësohet rruga për të shkuar në vendet e Bashkimit Evropian dhe për të rënë më lehtë në kontakt me punëdhënësin, pra më lehtë për të lidhur kontratë pune. “Siç kemi parë në medie, në Gjermani më nuk ke nevojë të kthehesh mbrapa në Kosovë ta

kërkosh një vizë pune, mirëpo shkon drejtpërdrejt në komunën ku e ke gjetur punën dhe aty do të pajisesh me dokumente për punë”, theksoi ai.

Rafuna thotë se këto shqetësime i kanë shtyrë bizneset të gjejnë mënyra të tjera që ta vërejnë sa më pak mungesën e fuqisë punëtore. “Po nga ikja e punëtorëve më së shumti do të jenë të prekur sektori i gastronomisë dhe sektori i ndërtimitarisë. Dihet që këtu dominon përqindja më e lartë e fuqisë punëtore të pakualifikuar dhe ata që janë të pakualifikuar janë më shumë



të prirë të dalin jashtë”, ka deklaruar ai.

Ai ka shtuar se nga anketat që kanë realizuar me 500 biznese, del se 70 % prej tyre janë të shqetësuar me mundësinë e mungesës së personelit të kualifikuar.

Gjatë intervistës Rafuna tha se sektori privat dhe ai publik duhet t'i rritin pagat dhe t'u ofrojnë kushte më të mira punëtorëve. “Sektori privat dhe sektori publik duhet t'i lëvizin pagat”, tha ai. Gjithashtu, ai theksoi se punëdhënësit, përveç rritjes së pagave, duhet të ofrojnë bonuse dhe ushqime për punëtorë.

Kompanitë e përpunimit të drurit nga Kosova marrin pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Ndërtimit “Swiss bau 2024”

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 12 JANAR - Dymbëdhjetë kompani të përpunimit të drurit do të përfaqësojnë një linjë të gjerë të produkteve dhe dizajneve të Kosovës në Panairin Ndërkombëtar të Ndërtimit “Swiss bau 2024”. Këto kompani kanë kompozuar një linjë impresionuese të produkteve që do të ekspozohen në pavijonin e Kosovës për bizneset dhe klientët e interesuar në Zvicër dhe me gjerë. Produkte sillen nga dyert dhe dritaret, te kuzhinat dhe mobiliat për dhoma gjumi, tavolina dhe karrige, mobilie për banjë, dyer ndarëse, rafte dhe produkte të tjera për ambiente të hapura. Pjesëmarrja e kompanive të Kosovës në Panairin Ndërkombëtar të Ndërtimit “Swiss bau 2024” është facilituar nga Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës (ShPDK) për herë të parë në vitin 2010, kurse qysh nga viti 2012 ShPDK-ja ka organizuar në vazhdimësi grupet për ekspozim në këtë panair. “Anëtarët tanë e shohin Zvicërën si një treg shumë tërheqës dhe fitimprurës për produktet e tyre”, ka theksuar Arieta Vula-Pozhegu, drejtoreshë ekzekutive e ShPDK-së.



Ajo ka theksuar se pjesëmarrja e tyre në këtë panair është një mundësi shumë e madhe për kompanitë individuale dhe për të gjithë industrinë e drurit të Kosovës që ta zgjerojnë tregun e tyre në Zvicër dhe në shtetet e tjera. “Pjesëmarrja e prodhuesve nga Kosova në panairin ndërkombëtar të kësaj shkalle dhe rëndësie gjithmonë ka

rezultuar me histori të suksesit. Përfaqësimi i shkëlqyer i kompanive tona dëshmon cilësinë dhe inovacionin e produkteve që prodhohen në Kosovë. Jemi të gatshëm ta ndajmë ekspertizën tonë dhe të krijojmë lidhje të reja të biznesit. Pas kësaj eksperience të suksesshme, shpresojmë që do të rezultojë me shumë

mundësi të reja bashkëpunimi dhe kontrata, të cilat do ta forcojnë pozicionin tonë në tregjet ndërkombëtare. Kjo do të rezultojë në një rritje të eksportit, duke kontribuar në zhvillimin e industrisë dhe rritjen e imazhit të Kosovës si një shtet inovativ dhe konkurrues”, ka pohuar Arieta Vula-Pozhegu. ShPDK, në bashkëpunim me

MINT, agjencinë KIESA dhe me mbështetjen e GIZ-EP dhe PPSE, mundësuan realizimin e këtij aktiviteti që është pjesëmarrja e 12 kompanive prodhuese nga Kosova në panairin më të rëndësishëm në sektorin e ndërtimit, Swiss Bau 2024 që mbahet në Bazël të Zvicrës nga datat 16-19 janar 2024.

Shkëmbimet tregtare Kosovë - Shqipëri thyen rekordin rreth 440 milionë euro

PRISHTINË, 12 JANAR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka bërë një studim rreth shkëmbimeve tregtare Kosovë - Shqipëri për vitin 2023. Nga ky studim del se ato janë rritur dukshëm në krahasim me vitin 2022. “Shkëmbimet tregtare mes dy shteteve tona Kosovë - Shqipëri për vitin 2023 thyen rekordin me importe dhe

eksporte mes bizneseve. Kosova ka importuar nga Shqipëria rreth 326 milionë euro, kurse bizneset e Kosovës kanë eksportuar 113 milionë euro. Nëse e krahasojmë me vitin 2022, shkëmbimet tregtare ishin 356 milionë euro, kurse në vitin 2023 ishin 439 milionë euro apo rritje rreth 83 milionë euro ose mbi 23 për qind më

shumë”, thuhet në këtë studim të AKB-së.

Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, ka thënë se, pavarësisht prej raporteve politike dhe qeveritare, bizneset, qytetarët dhe konsumatorët në të dyja anët rritin bashkëpunimin dhe besimin e ndërsjellë në të mirë të rritjes së ekonomisë kombëtare.



John Grisham | Avokati dhe djajtë

MAKINA Grisham nuk ndalet kurrë. Ai tashmë është duke shkruar me nxitim hitin e tij të radhës. Dhe ngadalëson shpejtësinë, një pasdite, në shtëpinë e tij në Virxhinia. Për të folur për pengje, jetën pas trëndafilave dhe padrejtësitë që nuk i duron dot, siç bëjnë shumë.



Në një intervistë të vitit 2009 ju thatë se, ndonëse jua kishin sugjeruar, nuk do të kishit shkruar kthimin e “Partnerit”, ose personazhit tuaj Mitch McDeere. Çfarë ju bëri të ndryshoni mendje?

“Gjetja e historisë së duhur. Mitch ishte fshehur për një kohë të gjatë, edhe brenda meje, pastaj u rishfaq në një intrigë ndërkombëtare. Ishte një mundësi për të studiuar një ligj që nuk e njihja. Dhe për ta bërë atë të udhëtojë kudo”.

Ndërsa po shkruanit Partnerin, mendoj se shihnit fytyrën e Mitch në mendjen tuaj. A shihnit në mendjen tuaj Tom Cruise ndërsa po shkruanit The Exchange?

“Është e pashmangshme. E pashë sërish në Top Gun: Maverick dhe është një i përjetshëm, mund të tregojë në çdo moshë. Dhe ai mund të jetë edhe borgjez, me një shtëpi të bukur dhe dy fëmijë”.

Në fakt, në momentin vendimtar, bashkëshortja e tij, Abby, rrëmben shfaqjen. A donit një personazh rozë në romanet tuaja?

“Gruaja ime më ka akuzuar gjithmonë se nuk i kam lënë hapësirë personazheve femra apo se i kam bërë plotësisht pasive. Dhe ajo kishte të drejtë. Doja të vërtetoja të kundërtën dhe nuk është aspak e lehtë të vihesh në vendin e një gruaje”.

Ka terroristë në histori, por ne nuk i shohim ata në veprim, dhe kur bashkëpunëtorët e tyre

shfaqen, ata janë burra të rafinuar dhe të sjellshëm, gra të sjellshme dhe empatike. Pse kjo zgjedhje?

“Unë tregova krimet e tyre, vrasjet çnjerëzore: ato flasin në emër të autorëve të tyre, i përshkruajnë më mirë se sa po t’i kisha treguar unë.”

Nuk e di nëse bini dakord, por besoj se pasi shkrimtari ka depozituar romanin e tij, atëherë secili lexues lexon një tjetër, me qendër dhe kuptim të ndryshëm. Ngaqë e lexova vetë, libri juaj i fundit “Shkëmbimi” e ka zemrën në një dilemë morale: sa larg je gati të shkosh për të shpëtuar jetën e një tjetri?

“Kështu është. Në fakt, zgjedhja personale e Mitch-it, ndryshe nga ajo e anëtarëve të tjerë të familjes, ishte të gjente guximin, aftësinë dhe gatishmërinë për të bërë sakrificat e nevojshme për të bërë gjithçka që ishte e mundur. Mendoj se do të isha i aftë për këtë. Ndoshta një kolegj, si në rastin e Mitch? Shpresoj gjithësesi. Është e qartë, përgjigja mund të gjendet vetëm në realitet, aty mund ta njohim njëri-tjetrin”.

Po shtetet? Ata vendosin fillimisht, ata duhet të miratojnë ligje për t’u ndjekur në rast se një nga qytetarët e tyre është në rrezik. Të negociohet apo jo për të liru një peng?

“Shtete të ndryshme i kanë dhënë vetes rregulla të ndryshme. Edhe në këtë rast, realiteti dominon. Dhe realiteti është një zonë gri. Ekziston një qëndrim zyrtar që përjashton

negociatat për të parandaluar përsëritjen e rasteve të rrëmbimit. Dhe pastaj ka prapakuinta. Dhe aty kërkohen zgjidhje që më pas nuk pranohen se kanë ndodhur. Por është e nevojshme të bëhet. Për të shmangur problemin të gjithë duhet të qëndrojnë brenda kufijve të tyre”.

Po sikur pengmarrja të ndodhë ashtu siç ndodhi më 7 tetor, nga Hamasi?

“Kjo është një histori tjetër, ka ndodhur tashmë, por kurrë në një mënyrë kaq të bujshme. Në të kaluarën ka pasur rrëmbime për të arritur shkëmbimin e të burgosurve. Ata kishin të bënin me luftëtarët. Këtu nuk kërkoheshin para apo shpërblime. Ishte një akt lufte. Ata donin të vdekur, shumë të vdekur, për të dënuar reagimin e Izraelit”.

Na presin vite të tmerrshme?

“Po, dhe ne nuk jemi gati. Madje ekziston mundësia që Amerika t’i adresojë ato duke rizgjedhur Donald Trumpin”.

Suksesi juaj ka vazhduar prej tridhjetë vjetësh. A e prisnit që do të shkonte kështu kur, në moshën trembëdhjetë vjeç, ujisnit trëndafila në një çerdhe?

“Ah, puna ime e parë, një dollar në orë, e mërzitshme si dreqi. Por jeta më befasoi. Nuk kam ëndërruar të shkruaj, por të bëhem sportist profesionist. Nuk eci. Kam humbur dy vite universitet para se të merrja rrugën e drejtësisë. U bëra avokat dhe më pëlqeu shumë, më pëlqente të isha në

sallën e gjyqit, të debatoja, të përgatitja debatin. Të shkruarit ishte hobi im sekret. Provova me librin e parë, “Një kohë për të vrarë”, dhe nuk funksionoi. Thashë me vete: edhe një dhe nëse nuk funksionon, do të heq dorë. Ishte “Partneri”. Gjithçka ndryshoi brenda një nate”.

Më pas ribotuat të parin dhe ishte një triumf. A e kishte gabim juria?

“Ai doli pothuajse në mënyrë klandestine, mund të ndodhë”.

A keni shkruar libra të këqij?

“Po. Një, njëzet e pesë vjet më parë. E bëra gruan ta lexonte dhe ajo tha: nuk është shumë i mirë. I dërgova një përmbledhje agentit tim, ai u përgjigj: harroje. Unë iu binda.”

A keni bërë kompromise? A keni shtuar ndonjëherë “tre skena seksi dhe një fund të lumtur”?

“Ma kërkoi një producent filmi, kur gabova dhe i dhashë të lexonte “Apelin” ndërsa isha duke e shkruar. Nuk e bëra”.

Le të themi se nuk ishte libri juaj i njëqindtë, por i dyti, ai “që o të ngre, o të zhyt”. A do të kishit pranuar?

“Sinqerisht... do të isha tunduar.”

Edhe fundi i lumtur? Ju thoni se nuk filloni kurrë një histori nëse nuk e dini se si do të përfundojë ...

“Po. Nuk dua të humbas gjatë rrugës. Të arrij në faqen dyqind, duke mos ditur si të vazhdoj dhe duke hedhur gjithçka tutje. Unë kam nevojë për një goditje dhe

një fund të paparashikueshëm, që para se të filloj.”

Dhe ku është bukuria, nëse dini tashmë gjithçka?

“Kur bashkon pjesët e historisë, i mban nën kontroll. Nuk mund të shkruaj ndryshe”.

A jetoni në të njëjtën mënyrë?

“Nuk eshte e mundur. Nuk mund të kontrollosh gjithçka. Shëndeti, deri në një pikë të caktuar. Shtëpia, paratë, po. Fëmijë, jo. Në fund të fundit, nuk ka kuptim të provosh. Siç thoshte John Lennon, “Jeta është ajo që të ndodh kur bën plane të tjera.”

Siç e pyeste Kurt Cobain Nirvanën një natë para se t’i jepte fund: A po argëtoheni ende?

“Po. Unë jam me fat. Privilegji im është të ngrihem në shtatë, të bëj kafe, të rri vetëm, në heshtje, i shkëputur nga gjithçka dhe të shkruaj për tre ose katër orë”.

Nuk do ta ndryshoni jetën tuaj, por a ju ka ndryshuar juve jeta?


“Siç i ndodh kujt do. Kur je njëzet e pesë vjeç, mendon se di gjithçka. Kur mbush pesëdhjetë e di se di pak dhe mbi të gjitha e ke kuptuar se të jetosh, do të thotë të mësosh.”

Çfarë keni mësuar?

“Jam rritur në jug, me edukim baptist. “Sy për sy e dhëmbë për dhëmbë” ishte zgjidhja e vetme. Duke u bërë jurist e kuptova që nuk ishte kështu, se nëse vrasja është e gabuar, është gabim edhe kur e bën shteti. Shumica tolerojnë padrejtësitë, tolerojnë abuzimin e policisë, dënimin me vdekje, sepse ata zgjedhin policinë dhe shtetin në vend të viktimave të abuzimit dhe dënimin me vdekje. Vendi është i ndarë, por po mësohet, ekzekutimet po bëhen gjithnjë e më pak dhe një ditë do të marrin fund. Duhet angazhim. Tani po luftoj me sindromën e foshnjës së tronditur. Shkenca e hedhurinave për vite me radhë ka vendosur përgjegjësinë për vdekjen e fëmijëve të vegjël mbi të afërmit ose kujdestaret e fëmijëve, që i shkundnin sepse qanin. Tragjeditë janë shndërruar në krime të bazuara në supozime të paprovuara. Ne po bëjmë apele, po përpiqemi të ndryshojmë ligjet, rast pas rasti, shtet pas shteti. Beteja kundër padrejtësisë është e gjatë, por mund të fitohet”.

A mund të ndryshohet ndonjë ndërgjegje duke shkruar?

“Nëse mbërrin tek shumë njerëz, ke pak ndikim. Nuk e di se çfarë ndikimi pata, por e di se u përpoqa”. (il venerdi – bota.al)



Përzgjedhësi i Rumanisë U21: Klubet rumune po kërkojnë lojtarë nga Kosova për shkak të Rrahmanit

BUKURESHT, 12 JANAR - Përzgjedhësi i Rumanisë U21, Daniel Pancu, ka thënë se ndikimi që Albion Rrahmani pati me paraqitjet e tij në kampionatin rumun, ka bërë që klubet rumune të vihen pas lojtarëve që luajnë në Kosovë. Rrahmani është kthyer së fundi nga një

lëndim, ndërsa për Rapid Bukureshtin kishte shënuar gjashtë gola dhe kontribuar me dy asistime në gjashtë ndeshjet e para. Craiova interesohet për transferimin e Lumbardh Dellovës, ndërsa Steaua Bukuresti është në bisedime për transferimin e Jalen

Blesas nga Prishtina. “Kur një lojtar si Rrahmani të jep rendimentin, normalisht shikon në atë zonë. Mbaj mend Petroluliu me Hamza Younes. Ai pati një rendiment shumë të mirë, pastaj pasuan 7-8 transferime të tjera nga ajo zonë. Unë kam qenë i vetmi rumun në Turqi në

vitet 2002-2003. Luajta futboll fantastik, fituam kampionatin. Vitin tjetër erdhi vetë më pas për shkak të punës serioze të trajnerit tim me mua”, ka theksuar Fazliu. Për Laurën, kujtimi më i frytshëm deri më sot është Kampionati Evropian në Sofje 2022, ku ajo fitoi çmimin e saj të parë evropian në formën e një medalje argjendi. Sipas momenteve kryesore të vitit 2023, ajo zgjedh Masters. “Sepse fitova kundër dy xhudisteve japoneze”, thotë ajo. Ajo udhëhiqet nga shembuj të jashtëzakonshëm. Në fakt, ajo ka fatin të udhëhiqet nga idhulli i saj, Majlinda Kelmendi. “Shpresoj që një ditë të arrij rezultatet e saj”, thekson xhudistja nga Mitrovica. Tokio 2020 ishte vrapimi i parë i Laurës në një provë olimpike. Ajo vetë e pranon se është e zhgënjyer



Laura Fazliu: Ëndërroj rezultatet e Majlinda Kelmendit

PRISHTINË, 12 JANAR - Kanë mbetur më pak se 200 ditë. Është vetëm çështje kohe para se të mbarojë gjithçka. Tensioni po rritet, ndërkohë që fokusi po ngushtohet në një gjë dhe vetëm një gjë, pra te Lojërat Olimpike “Paris 2024”. Aktualisht shumica xhudistëve po përgatiten në OTC Mittersill në Austri, duke përfshirë finalistin evropiane të vitit 2022 dhe medaljen e bronzit evropiane 2023, xhudisten kosovare Laura Fazliu. Fazliu ka dhënë rëfimin për karrierën e saj për faqen zyrtare të Federatës Evropiane të Xhudos, ku tregon hapat e saj drejt majave në sportin e xhudos, derisa pranon se ëndrra e saj është të arrijë rezultate dhe medalje si ato të Majlinda Kelmendit. Laura, e cila mban edhe pseudonimin e saj Laki, e ka nisur xhudon 10 vjet më parë, pasi kushëriri i saj e nxiste gjatë gjithë kohës se duhet



të merrej me xhudo. Nga tre vëllezërit e motrat brenda familjes së saj, ajo është e vetmja që praktikon xhudo në çdo nivel. Laura u lind dhe u rrit në Mitrovicë dhe në moshën 15-vjeçare iu bashkua ekipit të ëndrrave “Ippon” në Pejë. “Si fëmijë, unë isha një luftëtare dhe Toni trajneri im e pa talentin tim”,

thotë fillimisht Laura, raporton “KosovaPress”. Pavarësisht prej gjithçkaje që shohim, është lavdi e vazhdueshme, rruga e re nuk ishte e gjitha me lule. “Kur e lashë familjen dhe shkova në Pejë për t’u stërvitur, në fillim ishte shumë e vështirë për mua dhe disa muaj më pas doja të kthehesha në shtëpi sepse më mungonin

prindërit. Për fat të mirë, trajneri im dhe shokët e mi më ndihmuan të vazhdoj. Kam punuar shumë dhe rezultati erdhi vetë më pas për shkak të punës serioze të trajnerit tim me mua”, ka theksuar Fazliu. Për Laurën, kujtimi më i frytshëm deri më sot është Kampionati Evropian në Sofje 2022, ku ajo fitoi çmimin e saj të parë evropian në formën e një medalje argjendi. Sipas momenteve kryesore të vitit 2023, ajo zgjedh Masters. “Sepse fitova kundër dy xhudisteve japoneze”, thotë ajo. Ajo udhëhiqet nga shembuj të jashtëzakonshëm. Në fakt, ajo ka fatin të udhëhiqet nga idhulli i saj, Majlinda Kelmendi. “Shpresoj që një ditë të arrij rezultatet e saj”, thekson xhudistja nga Mitrovica. Tokio 2020 ishte vrapimi i parë i Laurës në një provë olimpike. Ajo vetë e pranon se është e zhgënjyer

por, po ashtu, i ka bërë një premtim vetes, që ishte se në Paris do të jetë atje. “Ëndrra për medaljen olimpike është e vazhdueshme dhe dua ta bëj për prindërit e mi. Ata janë arsyeja që e lashë shtëpinë time kur isha shumë e vogël dhe iu përkushtova xhudos. Unë jam duke punuar shumë. Shpresoj për më të mirën. Kam trajnerin më të mirë në botë, kështu që besoj tek ai dhe puna jonë. Xhudo është jeta ime. Nuk është vetëm një sport. Është gjithçka. Xhudoja më ka bërë kjo që jam sot për shkak të xhudos kam një karakter të fortë. Besoj në veten time dhe jam gati për gjithçka në jetë. Parisin përpiqem të mos e mendoj shumë, sepse më jep stres. Përpiqem të fokusohem në stërvitje dhe përmirësimin e xhudos dhe të jem në formën më të mirë për Olimpiadën”, ka përfunduar Fazliu.

Superliga, me superpërballje në fundjavë

PRISHTINË, 12 JANAR - Fundjava pritet të sjellë ndeshje shumë interesante në Prince Caffè Superligë. Java e 17 do të dhurojë spektakël, pasi ndeshen vendi i tretë me katërtin dhe i dyti me të parin, apo kampioni me nënkampionin. Kjo xhiro do të hapet me sfidën në mes të Sigal Prishtinës dhe Golden Eagle Yllit, ku të dy skuadrat kanë nga dhjetë fitore dhe gjashtë humbje, andaj do të jetë një ndeshje shumë interesante, ku të dyja skuadrat synojnë fitoren për t’u renditur në vendin e tretë, ndërkohë që kanë synime të mëdha në këtë edicion.

Edhe më interesante pritet të jetë sfida në mes të Pejës dhe Trepçës, vendit të dytë në renditje me 12 fitore e katër humbje dhe vendit të parë me 14 fitore e dy humbje. Këto dy skuadra u përballen në finalen e “Play-off”-it, ku verdhezinjtë ishin më të mirë 3:2 dhe u shpallën kampionë, derisa ‘Xehetarët’ i mundën në finalen e Superkupës. Në dy takimet e këtij edicioni, të dyja skuadrat kanë nga një fitore ndaj njëra-tjetrës. Peja kishte fituar 90:82, kurse Trepça fitoi 91:71. Të dielën Vëllaznimi do të ndeshet me Proton Cable Prizrenin, ku fitorja është shumë e



vlefshme për të dyja skuadrat. Kuqezinjtë janë vendin e pestë me

shtatë fitore e nëntë humbje, kurse prizrenasit kanë pesë fitore dhe 11

humbje, andaj sfida është shumë e rëndësishme. Takimi i fundit zhvillohet ndërmjet Istogut dhe Bashkimit. Istogasi që për herë të parë janë në Superligë, kanë një fitore e 15 humbje. Fitoren e vetme e kanë ndaj prizrenasve, që kanë pesë fitore dhe 11 humbje.

SUPERLIGA - Java 17

Të shtunën takohen:
17:00 Sigal Prishtina - Golden Eagle Ylli
19:00 Peja - Trepça

Të dielën takohen:
17:00 Vëllaznimi - Proton Cable Prizreni
19:00 Istogu - Bashkimi


Berisha: Në Derby për fitore edhe më të thellë

PRISHTINË, 12 JANAR - Haris Berisha ishte prej më të dalluarve në Përfaqësuesen e Kosovës në hendboll në fitoren ndaj Britanisë së Madhe. Berisha bëri 11 pritje dhe solli siguri në

mbrojtjen e “dardanëve” që fitoi me rezultat 30:22. Megjithatë, ajo ndeshje i takon së kaluarës. Fokusi është kthyer te ndeshja e dytë, që zhvillohet të shtunën prej orës 14:00 në Derby të

Anglisë. “Do të përpiqemi t’i përmirësojmë gabimet e ndeshjes së parë dhe të arrijmë rezultat bindshëm më të mirë. Duam të festojmë së bashku në fund, pastaj të përgatitemi për

pjesën finale të kualifikimeve për ‘Euro 2026’. Kosova e ka vendin në kualifikimet e rregullta dhe këtë duam ta dëshmojmë”, ka thënë Haris Berisha.



Januzaj fiton 2.7 milionë euro, zemërohen tifozët e Seville

Sevilla, 12 janar - Programi sportiv i La SER "Libre y Directo" zbuloi rrogën që merr Adnan Januzaj duke luajtur për Sevilan. Shifrat kanë ngjallur zemërimin dhe shqetësimin e tifozëve të Seville. Edhe pse Adnan Januzaj

mbërriti si transferim i lirë te Sevilla FC, ai është një nga nënshkrimet më të këqija në historinë e klubit spanjoll. Futbollisti me prejardhje shqiptare, qoftë për shkak të dëmtimeve të shumta të pësuar

apo për shkak të mungesës së angazhimit, ka marrë pjesë vetëm në 16 ndeshje që kur ka luajtur për skuadrën e Seville. Paga e Adnan Januzajt te Sevilla shkon në 2.7 milionë euro neto. Domethënë, ai i kushton klubit

të Seville 5.4 milionë euro bruto në sezon. Zbulimi i pagës së Adnan Januzajt ka ngjallur zemërimin dhe shqetësimin e tifozëve të Seville, të cilët duan që Januzaj të largohet nga skuadra.



Asani drejt La Ligas, por klubi korean ngre çmimin

TIRANË, 12 JANAR - Tri gola në kualifikueset e "Euro2024", për më tepër tri perla, rikthyen fuqishëm në skenë emrin e Jasir Asanit. I "harruar" në Korenë e Jugut, më saktë, larg futbollit të rëndësishëm, fanella kuqezi erdhi si një bekim për Asanin, jo vetëm iu realizua një ëndërr e madhe, ta përfaqësonte Shqipërinë, por tashmë pas paraqitjes fantastike me Kombëtaren, ai është gati të rikthehet në futbollin e rëndësishëm. Sulmuesi kuqezi ka tërhequr vëmendjen e disa ekipeve në Evropë, në Spanjë dhe jo vetëm, por në mënyrë surprizë pengesë është kthyer klubi i Gunzhus. Fillimisht klubi korean e vlerësonte 1.5 milion euro kartonin e Asanit, por pas paraqitjeve shumë të mira me Shqipërinë kanë rritur kërkesat. Asani ka edhe një vit kontratë me klubin korean, por nuk pritet të qëndrojë deri në fund. Ky sesion është ideal për t'u larguar. Ish-lojtari i Partizanit dhe agjenti i tij po negociojnë prej kohësh me klubin e Celta Vigos, ndërsa ka admirues edhe në



Francë dhe Gjermani. Me Evropianin përpara, Asani është në kërkim të një klubi që i

garanton minuta pasi kërkon që në "Euro2024" të shkojë në kushte të përkryera.

Milwaukee, 'leksion' Bostonit, lakersat humbasin ndaj Phoenixit



MILWAUKEE, 12 JANAR - Ky sezon ka qenë plot luajtje për disa nga skuadrat pretendente të NBA-s. Pasi Bostoni mundi skuadra kryesuese të Perëndimit, u mund përballë rivalëve të Milwaukee në

Lindje, që fituan 135-102. Një ndeshje e dominuar nga Bucks, ku u dalluan Portis me 28 pikë e Antetokounmpo me 24. Për Celticsin zhgënjyen të gjithë lojtarët "big". Megjithatë, Bostoni vijon ta

mbajë kreun në Lindje, ndërsa Bucks ngjitet në vendin e dytë. Në Perëndim vijon sezoni me hope i Los Angeles Lakers që, pas dy fitoreve rresht, u mund 127-109 në fushën e vet nga Phoenix Suns. Beal me 37 pikë dhe Booker me 31 bënë dallimin në fushë për Suns, ndërsa te Lakersi mungoi lojtari lider. Fitore të vështirë arriti Dallas Mavericks, që mundi 128-124 New Yorkun, me dyshen Irving-Hardaway, që së bashku realizuan 76 pikë, duke i bërë të pavlefshme 62 pikët e dyshes Randle - Brunson. Për Dallasin nuk u ndje shumë mungesa e liderit Luka Donqiq.

REZULTATET

Cleveland - Brooklyn	111-102
Milwaukee - Boston	135-102
Oklahoma - Portland	139-77
Dallas - New York	128-124
Lakers - Phoenix	109-127

SHKURT

Yoan Marc-Olivier: Dua të luaj me Prishtinën në Evropë

FC Prishtina e ka paraqitur edhe një përforcim në këtë afat kalimtar. Fjala është për sulmuesin Yoan Marc-Olivier, i cili është me shtetësi britanike dhe klubit kryeqytetas i bashkohet nga skuadra e Ballkanit. Ai ka djersitur fanellën e Malishevës dhe Istogut. "Jam te klubi më i trofeshme në Kosovë. Dua të luaj në Evropë me Prishtinën. Do të jap gjithçka në fushë, për tifozët, ekipin dhe të krijojme kujtime të mira së bashku", ka deklaruar Yoan Marc-Olivier.

Jaksa Vuliq emërohet trajner i KB Prishtinës

Klubi i Basketbollit Prishtina është bërë me trajner të ri. Në njoftimin e klubit është bërë me dije se trajneri i mirënjohur kroat Jaksa Vuliq është emëruar trajner i klubit kryeqytetas. "Vuliq së fundmi ishte kryetrajner i Cibonës së Zagrebit, Cedevitës në Kroaci, si dhe më herët ka drejtuar skuadra të njohura në Slloveni dhe Bosnjë, me të cilat u shpallë kampion dhe fitoi çmime si trajneri më i mirë", thuhet në njoftim.

Dier paraqitet te Bayerni

Eric Dier edhe zyrtarisht është lojtar i Bayern Munchenit. Futbollisti anglez është paraqitur në klubin gjerman, ndërsa ka nënshkruar kontratë deri në fund të muajit qershor. "FC Bayern ka nënshkruar me Eric Dier nga Tottenham Hotspuri në një marrëveshje deri më 30 qershor 2024, me opsion për një vit tjetër", thuhej në njoftim. Anglezi do ta veshë fanellën numër 15 në Munchen.

Dragusin përforcon Tottenhamin

Radu Dragusin është zyrtarisht një futbollist i Tottenham Hotspurit. Pas Timo Werner, "Spursat" kanë paraqitur edhe mbrojtësin rumun. Ai shkëlqeu me Genoan në gjysmën e parë të sezonit, duke tërhequr vëmendjen e shumë klubeve të mëdha evropiane, kurse mbrojtësi refuzoi ofertat e Milanit dhe Bayern Munchenit. Për Dragustinin, Tottenhami pagoi 30 milionë euro plus shërbimet e Xhed Spenc.

Xavi: Finalet nuk luhen, finalet fitohen

Barcelona fitoi ndaj Osasunës me rezultat 2-0 dhe u kualifikua në finale të Superkupës. Trajneri Xavi Hernandez është shprehur i kënaqur me suksesin e arritur, derisa për finale ka thënë se ato nuk luhen, por fiton. "Jemi të kënaqur për fitoren dhe vendin në finale. Ndeshja shkoi ashtu siç e kishim parashikuar. Ishte e vështirë të gjeje hapësira sepse ata mbylleshin shumë mirë, në mes kishte shumë pak hapësirë si dhe kishim nevojë për më shumë lëvizshmëri dhe kreativitet. Mendoj se ndryshimet na kanë ndihmuar për këtë. Në pjesën e dytë kemi dominuar dhe kemi shënuar dy herë", ka thënë Xavi. "Finalet nuk luhen, finalet fitohen. Jemi të bindur se na pret një takim shumë i fortë nga ajo çfarë pashë Realin në derbi. Kur flasim për 'klasiken' është e pamundur të thuash nëse është njëri apo tjetri favorit", ka deklaruar Xavi.

Dragusin përforcon Tottenhamin

Radu Dragusin është zyrtarisht një futbollist i Tottenham Hotspurit. Pas Timo Werner,

"Spursat" kanë paraqitur edhe mbrojtësin rumun. Ai shkëlqeu me Genoan në

gjysmën e parë të sezonit, duke tërhequr vëmendjen e shumë klubeve të mëdha

evropiane, kurse mbrojtësi refuzoi ofertat e Milanit dhe Bayern Munchenit. Për

Dragustinin, Tottenhami pagoi 30 milionë euro plus shërbimet e Xhed Spenc.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 43/1
Dt: 12.01.2024

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 35 të Ligjit për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, nenit 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Ligjit nr.08/L- 197 për Zyrtarët Publik, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

Ri-SHPALLJE E KONKURSIT
Për plotësimin e vendit të lirë në Qendra e Kompetencës në Ferizaj për vitin shkollor 2023/2024

Niveli	Institucioni/Shkoll a	Vendi	Pozita:	Vend i lirë/ Zëvendësi m	Numri i pozitave
SHML	Qendra e Kompetencës	Ferizaj	Mësimdhënës/e për Gjuhë Shqipe (14 orë mësimore)	Vend i lirë	1

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në Shkollë);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diplomat e kualifikimit, duhet të jenë të vërtetuara ose noterizuara;
- Certifikatat e noterizuara (certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë jo më të vjetra se gjashtë (6) muaj nga data e diplomimit;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriteve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHTI-it (UA Nr. 05/2021) si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Gjuhë Shqipe në shkollë të mesme të lartë:

- Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Bachelor (katërvjeçar 240 ECTS).

III. Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t’ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Vezë Fan” SH.P.K. Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811889726 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Vezë Fan” D.O.O. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811889726 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Vezë Fan” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 811889726 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Zena” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810394411 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Zena” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810394411 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Zena” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 810394411 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “Africa Balkans Trade And Culture Centre” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues 811896911.
- Gëzim Kollçaku shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit Juridik të UP-së, Prishtinë.
- Leutrim Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.
- Elvira Gojani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomë e sh.m. Mjekësisë “ Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Astrit Jusufi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.
- Bledar Topalli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I, II, III, IV dhe diplomën e sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

